KEK KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS Sh.a. KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C. ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C
KOSOVSKA ENERGETSKA KORPORACIJA d.d.
19 -09- 2023
Nr. 6127

# Shpallje Publike

Bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës, Seksionin V Pikën 3 (c) të Rregullores së KEK-ut Sh .a, dhe nevojave të paraqitura për plotësimin e disa vendeve të lira të punës në Divizionet e KEK-ut, Divizioni i Burimeve Njerëzore, më 19.09.2023 publikon shpalljen për pozitat e mëposhtme:

## Teknik te kimisë (19 kryerës)

**Qëllimi dhe fushëveprimi i vendit të punës:**

- Kryen punët përbrenda përgatitjes kimike të ujit dhe punët në reparte të prodhimit në lëminë e proçeseve kimiko-teknologjike. Kryen punët në përcaktimin e parametrave kimik të parapara për përcjelljen e poçeseve kimiko-teknologjike në Termocentrale në repartin e dekarbonizimit, repartin e demineraliziumit, sistemin ujë-avull, në sistemin e ujit të dekarbonizuar dhe ujit të demineralizuar për ftohje, thëngjill, produkte e djegies dhe hidrogjeni
- Në mungesë të Analizuesve të pavarur dhe gjatë kujdestarisë kryejnë dhe kujdesen për rregullësinë e kondicionimit të ujërave.
- Në bazë të nevojës bënë marrjen e mostrave në lëminë e përgjegjësisë së vet.
- Bënë evidentimin e analizave të përcaktuara me saktësi dhe pedantëri.
- Me urdhër të udhëheqësit të drejtpërdrejt dhe udhëheqësit tjerë ne vijën organizative kryen punë dhe detyra tjera komform aftësive profesionale.
- Përgjigjet për punën e vet. Mundet të angazhohet me aparatura në Laborator kimik dhe i përgjigjet drejtëpërsëdrejti Inxh. përgjegjës për Laborator kimik dhe kryeinxhinierit për procese kimike-teknologjike.
- Në rast të parregullsive gjatë proçesit të punës dhe implementimit të saj intervenon dhe njofton Inxh. përgjegjës për laborator kimik si dhe jep sygjerime për tejkalimin e parregullësive.
- Për punët dhe detyrat e parashtruara si dhe implementimin e tyre drejtëpërsëdrejti i raporton Inxh.përgjegjës në Lab. kimik dhe udheheqesit te PKU-s.
- Bartësi i punës bashkëpunon ngushtë me Inxh. përgjegjës të shërbimit dhe me inxh. tjerë përgjegjës si dhe me gjithë personelin që ka lidhje të drejtëpërdrejt me proçesin e prodhimit te ujit

### Kualifikimet

**Shkollimi**: SHKOLLA E MESME E LARTE TEKNIKE ose SHKOLLA E MESME PROFESIONALE –
**Drejtimi (dega)**: kimi, ose kimi-teknologji.
**Profili**: laborant i kimisë. Bartësi i punës duhet të ketë njohuri në përdorimin e sistemeve informatike, të ketë aftësi komunikative të jetë në gjendje të punojë i pavarur dhe në ekipe.

## Inxhinier i kimisë (4 kryerës)

**Qëllimi dhe fushëveprimi i vendit të punës:**

- Mbikëqyrë, koordinon dhe përcjellë punën e personelit në Laborator kimik.
- Në bashkëpunim me udhëheqësin e shërbimit përgatitë udhëzimet e analizave të parametrave kimik për përdorimin e instrumenteve laboratorike, të standardeve dhe tretjeve në kuadër të Laboratorit kimik në kontestin e kontrollës së parametrave kimik për përcjelljen e procesit kimiko- teknologjik.
- Në bashkëpunim me krye analizuesit kujdeset për kryerjen, saktësinë, rregullsinë dhe evidentimin e analizave kimike si: sistemit ujë-avull, sistemit të ujit të de-karbonizuar dhe të ujit të de-mineralizuar për ftohje, repartit të de-karbonizimit, repartit të de-mineralizimit, thëngjillit, produkteve të djegies dhe të hidrogjenit
- Kujdeset dhe bënë planifikimin e sasisë së kimikateve të nevojshme për kryerjen e analizave kimike.
- Në bashkëpunim me Analizuesit e pavarur bënë verifikimin periodik të saktësisë së matjeve të parametrave kimik.
- Përcjellë rregullsinë e kondicionimit të ujërave në bashkëpunim me inxhinieret përgjegjës në P.K.U-sit.
- Përkujdeset për zbatimin e rregullave, ligjeve në punë si dhe bënë vlerësimin kualitativ dhe kuantitativ të punës së manipuluesve.
- Përparon punën duke përcjellë të arriturat në lëmine e përgjegjësisë së vet.
- Me urdhër të udhëheqësit te drejtpërdrejt dhe udhëheqësit tjerë ne vijën organizative te kryen punë dhe detyra tjera komform aftësive profesionale dhe intelektuale të tij siç është puna ne komisione te ndryshme profesionale ,etj.
- Është përgjegjës për punën e vet, të personelit në Laborator kimik dhe angazhohet me të gjitha aparaturat në Laborator kimik i përgjigjet drejtpërdrejt udhëheqësit të PKU-s.
- Në rast të pa rregullsive gjatë procesit të punës dhe implementimit të saj intervenon dhe njofton udhëheqësin si dhe jep sugjerime për ti tejkaluar këto pa rregullsi. Drejtpërdrejt i raporton udhëheqësi te shërbimit por sipas nevojës edhe udhëheqësit te mirëmbajtjes apo edhe drejtorit te TEC-it. Bartësi i punës bashkëpunon ngushtë me inxh. përgjegjës të

shërbimit dhe me inxh. tjerë përgjegjës si dhe me gjithë personelin që ka lidhje të drejtpërdrejt me procesin e prodhimit te ujit ,Punëtoret e prodhimit në Laborator.

**Kualifikimet**

- Përgatitja e lartë shkollore bechelor i kimisë inxhinerike ose Fakulteti i kimisë –inxhinieri kimike
- Bartësi i punës duhet të ketë njohuri në përdorimin e sistemeve informatike, të ketë aftësi komunikative dhe ndërpersonale të mira, të jetë në gjendje të punojë i pavarur dhe në ekipe.

**KEK-u fton të gjithë të interesuarit, ne veçanti kandidatet femra dhe nga komunitetet pakicë, të aplikojnë për pozitat e publikuara**

Për me shume informata për pozitat e lartpërmendura vizitoni ueb faqen:.www.kek-energy.com, ikona *'Shpallje'* dhe mund ta shkarkoni *Aplikacionin* për pozitën që dëshironi të aplikoni. Aplikacioni i plotësuar bashkë me të dhënat tjera dërgohet përmes aplikimit online në vegzën përkatëse.
**Vërejtje:** Aplikacioni të jetë i kompletuar dhe mund të aplikohet vetëm një herë. Përveç *Aplikacionit* **duhet** të dorëzoni: per pozitën- **"Inxhinier i kimisë"** - diplomën e baçelorit të Fakultetit te Kimisë, ndërkaq për pozitën **"teknik i kimisë"** te dorëzoni diplomën e shkollës se mesme apo certifikatën e kryerjes se shkollës se mesme per profilin e kërkuar.
Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk do të pranohen ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen. Aplikantët të cilët nuk janë shtetas të Republikës se Kosovës duhet të kenë leje qëndrimin në Kosove. Kontrata e punës për të punësuarit për pozitën e zgjedhura do të jetë 1 (një) vjeçare me mundësi vazhdimi ndërsa puna provuese 6 (gjashtë) muaj.
Kandidatët e suksesshëm do të sistemohen në pozitat e lira sipas kërkesave nga divizionet operative të KEK-ut sipas kësaj shpallje. Ata/ato do të sistemohen në vendit të punës për 3 (tre) vite nga dita e kontratës se parë, pa të drejte ri-sistemimi.

Testimi do të bëhet në formë elektronike ashtu që vlerësimi do të jetë automatik. Procesi i testimit dhe intervistimit për kandidatët e Suksesshëm me qëllim të transparencës do të monitorohet nga kamerat.

**Prishtinë, 19.09.2023**

**Data e aplikimit deri më 04.10.2023 ora 24:00**

**Divizioni i Burimeve Njerëzore**

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS sh.a. – KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C. – KOSOVSKA ENERGETSKA KORPORACIJA d.d.
KEK
PRISHTINË-A